



BASHKIA GRAMSH

RELACION TEKNIK

**“ RIKONSTRUKSION I QËNDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE ”
QKF**

DHJETOR -2023-

Të përgjithshme

Objekti i cili do të nenshtrohet rikonstruksionit është e tipit godine social-kulturore e cila ndodhet në brendësi të qytetit të Gramshit, Bashkia Gramsh. Objekti ndodhet në lindje të qendrës dhe Bashkisë së Gramshit dhe ka një distancë nga qendra e qytetit prej 200 metra. Objekti i Qendrës Kulturore e Fëmijëve (QKF) ndodhet në një lartësi prej 218 metra nga niveli i detit. Ky objekt në vetvete është institucion social – kulturor dhe ka një funksionalitet të larmishëm në organizimin e evenimenteve kulturore-arsimore për qytetin e Gramshit. Qyteti i Gramshit pozicionohet në jug-lindje të Gramshit, i cili karakterizohet nga një reliev kodrinor –malor dhe klimë relativisht të ftohtë në dimër dhe të nxehtë në verë. Për nga ana kulturore, arsimore qyteti i Gramshit në raport me numrin e popullatës spikat dhe vlen të përmendet se është artdashës. Në qytetin/rrethin e Gramshit ndodhen ose janë të ndertuara disa objekte social kulturore ndër të cilat vlen të përmendim : Qendrën Kulturore të Fëmijëve, pallati i kulturës, pallati i sportit të lojtrave me dorë, stadium i futbollit etj.



Përsa i përket objektit të QKF-së, pjesë e këtij raporti teknik, duhet theksuar se ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave. Ky objekt është ndërtuar shumë vite më parë, dhe si rezultat i kohës kushteve atmosferike paraqet amortizim të dukshëm në disa zera, gjë që e bën të vështirë funksionalitetin e vet në organizimin e shfaqjeve kulturore, prova etj...

Gjendja aktuale e objektit Qendra Kulturore e Fëmijëve-QKF-

Aktualisht objekti QKF-së paraqitet i amortizuar pjesërisht dhe ky amortizim ndikon në vështirësitë e funksionalitetit të go-line. Nga inspektimi në vend që është bërë nga specialistët e Bashkisë së Gramshit është konstatuar se izolimi i taracës është jashtë funksionit ku lageshtia ka deportuar në brendësi të objektit dhe krijuar kushte papershtatshme. Gjithashtu nga inspektimi

ne vend eshte konstatuar amortizim edhe tek suvaja ne menyre te pjesshme,ku kerkoet meremetim ne pjesen e tavanit dhe mureve anesore.Nje gjendje jo e kenaqshme paraqitet edhe per dyshtemen e objektit te Qendres Kulturore te Femijeve QKF, e cila per konkluzionin e specialisteve te Bashkise duhet te pesoj rikonstruksion duke e veshur me pllaka.Eshte konstatuar qe edhe sistemi elektrik shfaq amortizim ku do ti nenshtrohet rikonstruksionit pjesor ku do te pasurohet edhe me shtesa. Ne perfundim rikonstruksionit te ketij objekti do ti shtohet edhe lyerja, e cila aktualisht paraqitet e perhumbur per sa i perket statusit social-kulturor.

Vizioni i Rikonstruksionit Qendra Kulturore e Fëmijëve-QKF-

Siç e përmendem edhe më lart rikonstruksioni i objektit “Qendra kulturore e Femijeve” do ti sherbeje jo vetem perditshtmerise se aktivitetve te qytetit/rrethit,por ky objekt pas rikonstruksionit do te sherbeje edhe si atraksion turistik per vizitoret te huaj apo vendas,te cilet do te kerkojne apo shfaqin interes sesi organizohet qytetit qe po vizitohet per nga ana e aktivitetve kulturore.Rikonstruksioni i ketij objektit do ta beje jeten kulturore dhe arsimore te qytetit me te larmishme dhe me dinamike, gjithashtu edhe funksionaliteti do te jete me komod dhe me i aksesueshem per femijet dhe stafin qe punon aty.



Sic edhe e theksuam ky objekt pas rikonstruksionit do te jete me atraktiv per nga ana kulturore,aktivitetve,ku femijet do te kene me shume deshire qe pervec mesimit te perditshem te meren apo te shtojne jeten e tyre edhe aktivite te ndryshme qe ofron QKF. Vizionit te Bashkise per sa i perket rikonstruksionit te kesaj godine do ti shtohet edhe nje kend lojrash ne miniatur,per ta sjelle kote projekt me te kompletuar ne funksionalitet. Gjithashtu koncepti i ketij projekt-ide te rikonstruksionit te QKF-së, do ti shtohet edhe nje gjelberim me i larmishem,i cili do ta ktheje QKF -në ne nje arkitekture te kohes .

Rikonstrukcionit të QKF-së do ti shtohet vizioni i kthimit të sallës së aktivitetit edhe si salla kinemaje. Pra është menduar në koncept dhe ide, që salla e madhe që ndodhet në brendësi të objektit të kthehet edhe në kinema, pa penguar funksionin që ka patur, përkundrazi të krijojë një larmitet në ushtrimin e aktivitetit social-kulturor të qytetit të Gramshit. Ky objekt deri më tani ka vuajtur edhe për një sistem ngrohje, e cila futet si zë që ka krijuar vështirësi në funksionalitetin e këtij institucioni. Bashkia Gramsh nëpërmjet këtij projekti për rikonstrukcion, ka menduar edhe për këto detaje, ku QKF-së do ti shtohet edhe sistemi i ngrohjes. I gjithë ky rikonstrukcion do ta rehabilitojë për një periudhë afat gjatë objektin e Qendres Kulturore të Fëmijëve, ku do të çojë në përmirësimin e kushteve të këtij institucioni dhe në kryerjen sa më komode të funksionit të tij.

Relatoi :

Ing. Orgent Çoniku



Miratohet :

Kryetari

Beslon AJAZI

